



Rregullorja e VS Tabor

Në shkollën tonë ne kujdesemi që përballë të gjithë personave ,të përdorim një gjuhë të sjellshme dhe të respektueshme,pavarësisht çfarë gjinie,religjioni ose prejardhje i përkasin ata.Ne në shkollën tonë përshëndesim dhe respektojmë të tjerët. Ne sillemi me të tjerët ashtu siq dëshirojmë ata të sillen me ne. Për ne,vlerat si, sjellja e mirëfilltë,respekti,toleranca,sinqeriteti,korrektësia si dhe gaditshmëria për të ndihmuar,kanë rëndësi të veçantë. Ne duam të gjithë të kontribuojmë,që shkolla e jonë të jetë një vend i mirë për të mësuar ku të gjithë e ndjejnë vetën mirë.

Ne mësuesit /mësueset

- jemi përgjegjës që mësimi të ketë përparësi.Themelore është kurrikula austriake.
- shikojmë që fëmijët të përqëndrohen dhe zhvillohen në punën e tyre.
- mundohemi për një klimë të mirë mësimore dhe marrëdhënje të mira mes prindit,mësuesit dhe nxënësit.
- kujdesemi për rrethana të mira në mësim
- kujdesemi për fëmijët 15 minuta para se të filloi mësimi,gjatë orëve të mësimit,gjatë aktiviteteve të ndryshme,si dhe gjatë pauzave.Prezenca jonë gjatë pauzave është e rëndësishme ngase mund ti zvogëlojmë konfliktet eventuale në mes të nxënësve.
- lajmërojmë me korrektësi për orarin mësimor,hartimet,për ndryshimin eventual të orarit për aktivitete (kohën,vendin,vendtakimin) si dhe fatkeqësitë eventuale,sëmundjet etj.
- kur fëmijët mungojnë ndonjëherë në shkollë,ne i ndihmojmë që detyryt e pakryera që ato ti kryejnë prapë.
- informojmë për sukseset në mësim,për sjelljet e nx. për rrezikun e suksesit si dhe ju ofrojmë ndihmë në këtë pikë.
- me dëshirë jemi në mbledhjet me prindër.
- për tu kuptuar sa më mirë ne kujdesemi të marrim përkthyes,nëse është nevoja.
- për të mirën e fëmijëve ,ne bashkëpunojmë me persona tjerë siq janë punëtorët social,konsultorë psikologjik të shkollave ,kujdestare të kopshteve etj.
- kur grinden nxënësit mes veti,ne ju ndihmojmë në procesin e pajtimit.

Ne prindërit ...

- dërgojmë fëmijët me kohë të caktuar në shkollë dhe marrim përgjegjësi që ata edhe pasdite të vijnë në kohë të caktuar në shkollë.
- dimë për orarin e shkollës së fëmijëve tonë.
- nëse fëmiu mungon një ditë në shkollë, lajmërojmë shkollën po atë ditë (prej orës 7.30 ose në 9.30) dhe tregojmë shkakun e mungesës.
- për komunikim, përdorim fletoren e prindit. Nëse fëmiu është i sëmurë ose nuk guxon të bëj ushtrime fizike, këtë e shkruaj në fletoren e prindit.
- marrim pjesë në mbremje të prindërve, dhe nëse jo, lajmërojmë shkollën.
- njoftojmë menjëherë shkollën për ndërrimin e numrit të telefonit ose ndërrimin e adresës.
- paguaj shumat e parave në kohë.
- kujdesemi për të gjitha gjërat të cilat i duhen fëmijëve në shkollë.
- marrim përgjegjësinë për dëmtimin e gjërave në shkollë dhe kujdesemi që fëmiu ta përmisoj këtë
- nuk parkojmë automjetin dhe nuk pimë duhan në parkingjet para shkollës.

Ne nxënësit / nxënëset

- vimë të përpiktë në shkollë dhe jemi në klasë para se të filloj mësimi.
- në shkollë mbathim papuçe.
- marrim pjesë aktiv në orën e mësimit dhe nuk pengojmë të tjetët.
- grindjet sharjet, rrahjet i zgjidhim së bashku me biseda.
- respektojmë rregullat e klasës, pauzës dhe shkollës.
- .
- lëmë klasën në gjendje të rregullt dhe toaletin e lëmë poashtu të pastër.
- kujdesemi për mjetet e lojës, materialet mësimore dhe gjërat e shkollës.
- nga shkolla largohemi vetëm me leje.
- i ndalim telefonat e dorës.
- mbajmë përgjegjësi për gjërat që i dëmtojmë dhe kujdesemi për përmisimin e tyre.